Bielefeld
Bildungsregion

Albanisch

# Lista kontrolluese / Tipet / Terminet„Ku, pas shkollës fillore të ulët?“

**→ Çka duhet të mirret parasysh pas ndërrimit prej shkollës fillore të ulët në atë fillore të lartë (klasën e 5)**

| | |
|---|---|
| **09.10.2019** | Organizimi „Ku pas shkollës fillore të ulët?“ |
| **11/12- 2019 deri 01-2020** | **Mbrëmje informative sidhe ditë të dyerëve të hapura në shkollat fillore të larta**<br><br>➡ TIP: Terminet i gjeni edhe në Internet në www.bildung-in-bielefeld.de apo www.bielefeld.de (fjala Bildung / Schulen) |
| **27.01.2020 - 31.01.2020** | **Dhënia e Çertifikatave gjysmëvjetore në shkollat fillore të ulëta**<br><br>**Dorëzimi i Formularëve të regjistrimit** për shkollat komunale<br><br>Ju do të merrni **një** Formular personal të regjistrimit nga shkolla fillore e fëmiut tuaj. Ju lutemi ta plotësoni këtë dhe ta merrni me vete për t'u regjistruar në një shkollë fillore të lartë (Weiterführende Schule) komunale. |
| | → Nëse dëshironi ta regjistroni fëmiun tuaj në një **shkollë private**, atëherë informacionet rreth procesit të regjistrimit, do ti pranoni nga shkolla private përkatëse. |
| | **Këshilla për zgjedhjen e shkollës fillore të lartë**<br><br>Hauptschule, Realschule, Sekundarschule, Gesamtschule, Gymnasium = Shkollat fillore të larta = SEK I Shkollat = Klasat 5-10<br><br>➡ **KËSHILLA:**<br><br>✓ Merrni parasysh rekomandimin e përkohshëm për formën e shkollës fillore!<br>✓ A i përshtatet koncepti (pedagogjik) i shkollës nevojave të fëmiut tuaj?<br>✓ Sipas mendimit tuaj, cila shkollë do të mbështesë më së miri fëmiun tuaj?<br>✓ Cilat përshtypje keni fituar ju/ fëmiu i juaj gjatë ditës së vizitës që keni bërë?<br>✓ Rruga për në shkollë? A mundet që fëmiu i juaj të arrijë shkollën mirë dhe në mënyrë të sigurtë?<br>✓ A është shkolla një shkollë me orarë të plotë apo gjysmë ditore?<br>✓ (A posedon një mbikëqyrje në orët e pasditës?)<br>✓ A është shkolla një shkollë komunale apo private? |
| **15.02.2020 - 13.03.2020** | **Periudha e regjistrimit në shkollat fillore të larta komunale**<br><br>→ Për të lehtësuar shkëmbimin midis jush dhe udhëheqësve të shkollës, do të keni në dispozicion udhëheqësit e shkollave **në veçanti më datën 19.02.** (prej orës 09.00-12.00 + 16.00-19.00), **20.02.** (9.00-12.00) dhe **21.02.2020** (9.00-12.00). |
| | → **Terminet për regjistrim në shkollat fillore të larta private** orientohen në shkollat komunale. Datat konkrete të aplikimit ju lutemi kërkoni në shkollën private përkatëse. |

**www.bildung-in-bielefeld.de**

© Bildungsbüro der Stadt Bielefeld

**→ Çfarë duhet të bëni kur të bëni ndërrimin nga shkolla fillore e ulët në atë fillore të lartë (klasa 5)**

<table>
<tr><td></td><td colspan="2">

**Regjistrimi në shkollën fillore të lartë**

Regjistrimi bëhet në zyrën / sekretariatin e shkollës fillore të lartë përkatëse.<br>
**→ Çfarë duhet të sjellni me vete për regjistrim?**

- ✓ Formulari i regjistrimit, i plotësuar (→ Formularin e regjistrimi e pranoni nga shkolla juaj fillore e ulët)
- ✓ Çertifikata e fundit e gjysmëvjetorit (klasa 4) e fëmiut tuaj nga shkolla fillore e ulët, përfshirë rekomandimin e përkohshëm për formën e shkollës
- ✓ Çertifikatën e lindjes së fëmiut tuaj që duhet të regjistrohet në shkollën fillore të lartë
- ✓ Nëse posedoni: dëshminë se fëmija juaj din të notojë
- ✓ (-> p.sh. Dëshmia e marrjes së markës së notit „Seepferdchen“ (kal deti))

</td></tr>
<tr><td>

**prej**<br>**16.03.2020**

</td><td>

**Vendimi** se a është **pranuar** fëmiu i juaj në shkollën fillore të lartë vijon shumë shpejtë pasi që të ketë përfunduar periudha e regjistrimit.

Ju do të informoheni me shkrim nga Shkolla fillore e lartë.

</td><td>

→ Nëse fëmiu i juaj nuk është **pranuar në një shkollë** të cilën e keni përzgjedhur (për shembull, nuk ka vende të mjaftueshme në shkollë), atëherë do të pranoni një **letër refuzim** nga shkolla sidhe **formularin origjinal të regjistrimit.** Me këtë njoftimrefuzimi sidhe formularin e regjistrimit, ju mundeni që ta regjistroni fëmiun tuaj në një shkollë fillore të lartë tjetër.

Në faqen e internetit të qytetit Bielefeld ( www.bielefeld.de) mund të gjeni se cilat shkolla kanë ende vende të lira.

</td></tr>
<tr><td></td><td colspan="2">

**Tiketat e rrugës për në shkollë / Shpenzimet e rrugës së nxënësit**

Kur ju takon një Tiketë udhëtimi falas për në shkollë për fëmijën tuaj?

**→ Parakushtet:**

- Shkolla fillore e lartë të cilën e ndjek fëmiu i juaj nga klasa e 5-të është shkolla më e afërt e shkollës e shkollave të zgjedhura (Realschule, Sekundar-schule, Gesamtschule, Gymnasium)
- Distanca nga shtëpia e fëmiut tuaj deri në shkollën më të afërt të tipit të zgjedhur të shkollës është të paktën 3.5 km në këmbë<br>→ Në një distancë më të shkurtër (< 3.5 km), shpenzimet e udhëtimit paguhen vetëm nëse rruga drejt shkollës është veçanërisht e rrezikshme (në kuptim të Rregullorës për shpenzimet e udhëtimit të nxënësve) ose nëse ka shkaqe shëndetësore (të vërtetuara me një Çertifikatë mjekësore).

➡ **TIPP:** Informata të mëtejshme mund të gjeni edhe në **fletëpalosjen "Shpenzimet e Udhëtimit për nxënsa"** (gjenden në Zyrën e Shkollës ose në Entin e Shkollës) ose në internet në www.bielefeld.de (fjalë kyçe: Bildung / Schule / Schülerfahrtkosten)

</td></tr>
<tr><td>

**12.08.2020**

</td><td colspan="2">

**Dita e parë e shkollës për klasën e 5-të në vitin 2020**

**Urime! Fëmiu i juaj së shpejti do të fillojë një fazë të re të jetës!**<br>**Ju urojmë fat dhe sukses!**

</td></tr>
</table>